



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë , më ____/____/ 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **Operatorin ekonomik "Ligus" sh.p.k**

Procedura e prokurimit: "E HAPUR "

1. Numri i referencës së procedurës/lotit: 58924-03-27-2018

1. Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje makineri paisje (automjete)" me fond limit 43.200.000 (dyzetë e tre milionë e dyqind mijë) lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BO"Pastrime Silvio sh.p.k & Timak sh.p.k

K91413010N & L62030020B

Vlera 40.900.000 (dyzetë milion e nëntëqind mijë) lekë pa tvsh.

2. "Ligus" sh.p.k

L51523001S

Vlera 41.050.000 (dyzetë e një milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

3.Mektrin Motors sh.p.k

K51408501P

Vlera 42.000.000(dyzetë e dy milion)lekë pa tvsh

4.Rrapi Myzeqari sh.p.k

K44327401O

Vlera 0(zero)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BO”Pastrime Silvio sh.p.k & Timak sh.p.k

K91413010N & L62030020B

Vlera 40.900.000(dyzetë milion e nëntëqind mijë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Autoriteti Kontraktor në shtojcën 9 /Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit ka kërkuar si më poshtë:

Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të dorëzohen:

- a) Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi I operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht
- b) B) Prokurë e posaçme

Bashkimi I operatorëve ekonomikë Timak dhe Pastrimi Silvio kanë paraqitur Kontratën e bashkëpunimit me nr.Ref 1180,Kol 783 të datës 20.04.2018 ku përcaktohen saktë përqindjet e bashkëpunimit, operatori ekonomik “TIMAK” sh.p.k ka marre persiper 60% të furnizimit të mallrave si dhe operatori ekonomik Pastrime Silvio sh.p.k I cili ka marre persiper 40 % të furnizimit të mallrave .Në nenin 74 pika 2 të VKM-së 914 “Për Miratimin e Rregullave të Miratimit Publik”, I ndryshuar shprehen qartë elementët që duhet të përmbajë kontrata e bashkëpunimi të cilat janë:

Bashkimi krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar ku të përcaktohen përfaqësuesi I grupit , **përqindja e pjesmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkret që duhet të kryejnë secili nga anëtarët e bashkimit.**

K.V.O konstaton se Bashkimi I Operatorëve ekonomikë të mësipërm nuk e ka përmbushur kriterin e kërkuar në shtojcën 9 të DST pasi në kontratën e bashkëpunimit nuk janë përcaktuar **elementët konkret** në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Sa më sipër dokumentacioni I paraqitur nga bashkimi I Operatorëve ekonomik lidhur me kontratën e bashkëpunimit është I paplotë për rrjedhojë I pavlefshëm.

Si edhe ne preventivin e paraqitur nga operatorët ekonomike nuk kane bere ndarjen e zërave të furnizimit të mallrave që kanë marrë përsipër sipas ndarjes së përqindjes së mallrave të furnizuara.

Ne kreun VIII (kushte te pergjithshme per zbatim) ne nenin 74 te V.K.M nr.914,date 29.12.2014 “I ndryshuar ,shprehimisht parashikohet se

1.Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatoresh ku njeri prej te cileve I perfaqeson te tjeret gjate procedures edhe ne rast perzgjedhje edhe gjate zbatimit te kontrates.Ne oferte duhet

te percaktohet pjesa e sherbimit,punes,ose furnizimit qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në shtojcën 9 e DT shprehet se ...”Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumentave të rreme e të pasakta konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

2.Mektrin Motors sh.p.k

K51408501P

Vlera 42.000.000(dyzetë e dy milion)lekë pa tvsh

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ pika 2 d)si më poshtë cituar:

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS ”ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 807 prot, date 16.03.2018 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “MEKTRIN MOTORS” ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 16.03.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Shkurt 2018.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht **muajin Shkurt 2018.**

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 28.03.2018 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 23.04.2018 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Shkurt 2018 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

3.Rrapi Myzeqari sh.p.k

K443274010

Vlera 0(zero)

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “RRAPI MYZEQARI” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “RRAPO MYZEQARI” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në

Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **24.04.2018**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Neni 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomik **“BO”Pastrime Silvio”&TIMAK sh.p.k** hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.12178 Prot. datë 25.04.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **” Blerje makineri paisje (automjete)”**

Me marrjen e ankesës nga Bashkimi Operatorëve Ekonomikë të mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 9870/4Prot. dt. 25.04.2018, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 9870/5 Prot. datë 25.04.2018, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e Bashkimit të operatorëve **Pastrime Silvio”&Timak sh.p.k** ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm dhe është konsideruar i drejte dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatorëve Ekonomik **“BO”Timak &Pastrime Silvio ” shpk** me ane të shkresës Nr.12178/1 datë 27.04.2018 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 09.05.2018, me anë të shkresës nr. 9870/6, është hequr pezullimi i Urdhërit pasi janë respektuar afatet e ankimit pranë KPP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **LIGUS sh.p.k** me vlerë 41.050.000(dyzetë e një milion e pesëdhjetë mijë) **pa tvsh** pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **24.04.2018**

Ankesa: **PO**

Ka marrë përgjigje më datë **27.04.2018**.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

REDI MOLLA

